

## Thirrja për nominime- Çmimi Vjetor për Angazhim Qytetar

Të nderuar qytetarë,

Në këtë periudhë të fundvitit, është momenti për të vendosur në qendër të vëmendjes ata individë apo grupe të qytetarëve, të cilët përmes kontributit në komunitet, angazhimit dhe aktivizmit të tyre, kishin një ndikim të jashtëzakonshëm në komunitetin.

“Komisioni për Çmimet e Mirënjohjes Publike”, ka kënaqësinë që të shpallë të hapur procesin për nominimet për “Çmimin vjetor për angazhim qytetar”.

Me këtë rast, komisioni do të vlerësojë kandiduarat e të gjithë të nominuarve që pranohen në formatin e nominimeve të hapura, të cilët në cilësinë e tyre si individë apo në forma të organizuara të grupeve formale apo jo-formale, kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e komunitetit si dhe adresimin e sfidave dhe problemeve të komunitetit në raport me organet komunale.

Të nominuarit duhet së paku të plotësojnë tre nga kriteret si vijon:

1. Kontributi dhe ndikimi në komunitetin i evidentuar përmes prezantimit të ideve dhe nismave që kanë pasur ndikim pozitiv në komunitet
2. Pjesëmarrje publike aktive në takimet, diskutimet dhe forumet publike të organizuara nga Komuna
3. Nxitja e përfshirjes së qytetarëve në komunitet për të adresuar kërkesat e qytetarëve në raport me organet komunale
4. Prezantimi i ideve apo nismave për zgjidhjeve inovatore për të adresuar çështjet e komunitetit në raport me organet komunale
5. Avokimi për çështjet e komunitetit në raport me organet komunale, përmes kontributit në procesin e konsultimit publik, procesin e planifikimit buxhetor dhe konsultimit publik për politikën lokale.

Për të nominuar një individ apo një grup formal ose jo-formal për “Çmimin vjetor për angazhim qytetar”, Ju lutem, vizitoni faqen zyrtare të internetit të komunës në linkun si vijon: [www.....](http://www.....) ku do të gjeni të gjitha detajet lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si dhe të plotësoni formularin e nominimit.

Nominimet do të pranohen deri me datë 12 Dhjetor 2023.

Le të bashkohemi në këtë iniciativë të përbashkët për të vlerësuar dhe nderuar të gjithë ata qytetarë që me aktivizmin e tyre kanë bërë ndryshime positive dhe transformuese në komunitetin tonë!

Ju faleminderit për nominimet tuaja!

Anëtarët e Komisioni Komunal për Çmimet e Mirënjohjes Publike